

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **242-26-6555-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **“Furnizimi, instalimi dhe konfigurimi i infrastrukturës Wi-Fi për mbështetjen e aplikacionit eVijueshmëria në njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Botek shpk
NUI	600151328
Adresa	Rr. Agim Ramadani, Objekti C, Prishtine
Vendi	Kosove
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	038245830
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Hilmi Asllani
Adresa elektronike	hilmi.asllani@bo-tek.com; office@bo-tek.com; botekoffice@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	28.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

“Furnizimi, instalimi dhe konfigurimi i infrastrukturës Wi-Fi për mbështetjen e aplikacionit eVijueshmëria në njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës”

Njoftim per kontrate, 07.08.2026

Afati i fundit per dorezim, 01.09.2026

Sqarimet e publikuara date 21, 28.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

26.08.2026 kemi bere Kerkese per Rishqyrtim

27.08.2026 kemi pranuar vendimin

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LPP: Neni 6, 7, 8 dhe 9

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejtshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Mungesa e nevojës reale dhe e arsytimit për iniciimin e aktivitetit

Konsiderojmë se iniciimi i këtij aktiviteti nuk është mbështetur në një nevojë të re, reale dhe të mjaftueshme të Universitetit të Prishtinës, në kuptim të Nenit 9 të LPP-së.

Nga dokumentacioni rezulton se qëllimi fillestar ishte digjitalizimi i evidentimit të vijueshmërisë përmes **ID kartelave të integruara me sistemin SALTO**, ndërsa më pas zgjidhja është ndryshuar në evidentim përmes kodeve QR dhe infrastrukturës Wi-Fi. Vetë AK-ja deklaron se **“ndryshimi ka të bëjë vetëm me zgjidhjen teknike”** dhe se qëllimi i fondeve ka mbetur i njëjtë.

Në këtë kontekst, është veçanërisht relevante ekzistenca e **sistemit SALTO**, i cili është në përdorim prej vitesh në Universitet dhe përmbush edhe funksionin e evidentimit të vijueshmërisë përmes ID kartelave. SALTO nuk kufizohet vetëm në këtë funksion dhe, përmes avancimit dhe integritetit të tij, mund të shërbejë edhe për kontrollin e qasjes dhe sigurinë e objekteve, si dhe për menaxhimin dhe optimizimin e konsumit të energjisë. Për rrjedhojë, para krijimit të një investimi të ri do të duhej të vlerësohej mundësia e avancimit të një sistemi ekzistues, në vend të financimit të një infrastrukture të re për një funksion që tashmë mund të përmbushet.

Duhet të kihet parasysh se sistemi SALTO funksionon mjaft mirë tash e më shumë se sa vite, pa ndonjë mirembajtje dhe nuk ka pasur ndonjë mangësi në funksionim, të raportuar nga AK Universiteti i Prishtinës.

Fakti që AK-ja deklaron se **SALTO nuk është braktisur dhe se mirëmbajtja e tij është paraparë si aktivitet i veçantë** nuk e zgjidh këtë çështje. Përkundrazi, lind pyetja pse, nëse sistemi ekzistues vazhdon të jetë funksional dhe përmbush edhe evidentimin e vijueshmërisë, po krijohet një zgjidhje alternative dhe po bëhet një investim i ri në Wi-Fi për të njëjtin funksion.

Po ashtu, fakti që aktiviteti është proceduar me vonesë për shkak të miratimit të buxhetit, hartimit të specifikimeve dhe ndryshimit të mënyrës së realizimit, ndërsa njëkohësisht kërkohet shkurtime i afatit dhe trajtimi me prioritet, kërkon që urgjenca e pretenduar të mbështetet në një nevojë objektive dhe të dokumentuar dhe jo në vonesat e krijuara gjatë

planifikimit.

Tërësia e rrethanave – ekzistenca e një sistemi funksional SALTO, ndryshimi i zgjidhjes fillestare, ndryshimi i arsytimit nga një zgjidhje për vijueshmërinë në një nevojë më të gjerë për Wi-Fi, si dhe mungesa e një analize të dokumentuar të alternativave – ngre dyshime serioze se nevoja dhe objekti i këtij aktiviteti mund të jenë përcaktuar mbi bazën e një zgjidhjeje të paracaktuar, ose thënë më qartë për të favorizuar OE të caktuar, me qëllim të përmbushjes së interesave personale të dikuj, në dëm të fondeve publike

Për këtë arsye, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues të verifikojë nëse, para inicimit të aktivitetit, është kryer realisht vlerësimi i kërkuar nga Neni 9 i LPP-së, përfshirë **nevojën konkrete, alternativat ekzistuese, përfitimet, kostot dhe arsytimin për mosshfrytëzimin apo avancimin e sistemit SALTO.**

Në mungesë të një vlerësimi të tillë, konsiderojmë se nuk është dëshmuar nevoja reale dhe ekonomike për këtë investim dhe se ekziston rrezik i përdorimit joefektiv dhe të pajustificuar të fondeve publike. **Për rrjedhojë, kërkojmë që ankesa të aprovet dhe aktiviteti i prokurimit të anulohet në tërësi.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet e shkaktuara me rastin e pergaditjes se KpR dhe ankeses

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*